




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government



Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesuese e kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 16.09.2020 Nr-020-783/3
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr. 104/02-20723/20, për ndryshim plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës 01Nr.01nr.18863/19 të datës 28.06.2019, për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

I miratuar më datë: 08.09.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 11.09.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government

Za:	Besim Ilazi, gradonačelnik opštine Kačanik Kemal Merseli, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a
Od:	Venera Çerkini, direktorka Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS
1. Službenik za utvrđivanje pravne procene 2. Službenik-ca za izradu pravne procene	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština, Gëzim Sahiti, službenik za monitorisanje opština
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka skupštine opštine

Dana,
16.09.2020.
Br.020-783/8

Uvažani gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovalčenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o administrativnim oblastima i odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01br. 104/02-20723/20, o dopuni i izmeni odluke Skupštine opštine 01br.01br.18863/19 od dana, 28.06.2019. godine, za formiranje komisije za razmatranje želbi stranaka u postupku davanja na korišćenje nepokretne imovine.
Usvojena dana, 08.09.2020.godine
Dostavljena na razmatranje u MLS-u dana, 11.09.2020. godine

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta, ocenjuje da je opštinski akt u *proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi* i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za svako dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

HYRES-ULAZNA-INFORMACIONE
REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERISJE I QARKUT VJARRA QARKU I GOVERMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Shërbime Lokale Samouprave / Administration
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 11.09.2020 Komuna e Kaçanikut
Date

Emri i organizatës Nr. i Lëndës Shënimi
Kaçanik
-51- 020-78318 Municipali Kaçanik
01NR. 104/02-20723/20
Kaçanik, 08.09.2020

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019, duke vendosur sipas Propozimit Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-20723/20, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e në mbledhjen e mbajtur me 08 Shtator 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR. 01NR.18863/19 TË DATËS 28.06.2019 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit Komunal 01 Nr. 18863/19 të datës 28.06.2019- Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet të paragrafi 1.2 i pikës 1 të vendimit, ashtu që:

2.1 Nga komisioni i ankesave hiqet, Shpend Krusha, ish anëtar i KK nga Lëvizjes Vetëvendosje i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit, e që nënkupton se i lirohet nga të gjitha përgjegjësitë e tij të cilat i kishte si dhe lirohet po ashtu edhe nga të gjitha komisionet në të cilat ishte anëtar.

2.2 Në vend të anëtarit të hequr caktohet për anëtar të komisionit, Agim Mani, anëtar i KK nga Lëvizja Vetëvendosje.

3. Me ndryshimet të cilat janë bërë, Komisioni i Ankesave ka këtë përbërje:

- 1.1. Vlora Dalloshi, anëtare e KK nga PDK;
- 1.2. Agim Mani, anëtar i KK nga LVV;
- 1.3. Zekeria Koxha, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
- 1.4. Edmond Mjaku, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës;
- 1.5. Milazim Salijaj, anëtar nga shoqëria civile (gjeometër).

4. Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesem: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.


Vendimi u dërgohet:

Kryetarit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së Urbanizmit Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Merseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
01Nr. 104/02-20723/20
Kaçanik, 08.09.2020

Na osnovu člana 12. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosovo br. 28/04, jun 2008) člana zakona br. 06 / L-092 o zakupu i zameni nepokretne imovine opštine (Službeni list Republike Kosovo br. 10/03, april 2019, odlučujući prema Naertu odluke predsednika opštine br. 104 / 02-20723 / 20, Skupština opštine Kaçanik je na sastanku održanom 8. septembra 2020. uzela sledeće:

O D L U K A

ZA IZMENU I DOPUNU ODLUKE SKUPŠTINA OPŠTINE 01 BR. 01NR.18863 / 19 OD 28.06.2019. O OSNIVANJU KOMISIJE ZA RAZMATRANJE ŽALBI STRANA U POSTUPKU DODELE NEPOKRETNOSTI OPŠTINE

1. Ovom Odlukom izmijenjena i dopunjena Odluka Skupštine opštine 01 br. 18863/19 od 28.06.2019- O obrazovanju Komisije za razmatranje žalbi stranaka u postupku dodele nepokretne imovine opštine u upotrebi.
2. Izmene Odluke Skupštine opštine definisane u tački 1. ove odluke, izvršene su u stavu 1.2 tačke 1. odluke, tako da:
 - 2.1 Iz komisije za žalbe uklonjen je Shpend Krusha, bivši član SO iz Pokreta Vetevendosje, koji je podneo ostavku na mesto članova skupštine, što znači da je oslobođen svih svojih odgovornosti koje je imao i takođe je pušten, takođe iz svih odbora u kojima je bio član.
 - 2.2. Umesto uklonjenog člana imenuje se za člana komisije Agim Mani, član SO iz Levizie Vetevendosje.
3. Sa izvršenim izmenama, Komisija za žalbe ima sledeći sastav:
 - 1.1. Vlora Dalloshi, član MA iz PDK;
 - 1.2. Agim Mani, član MA iz LVV;
 - 1.3. Zekeria Koxha, član opštinske izvršne vlasti;
 - 1.4. Edmond Mjaku, član izvršne vlasti;
 - 1.5. Milazim Salijaj, član civilnog društva (geometar).
4. Ostale tačke Odluke ostaju nepromenjene.
5. Za sprovođenje ove odluke pobrinuće se: Predsednik Opštine, Direkcija za urbanizam i zaštitu životne sredine i Direkcija za ekonomiju, finansije i razvoj.
6. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokotarnoj kancelariji nadzornog organa - MALU, kao i nakon objavljivanja na zvaničnoj veb stranici opštine. Odluka se šalje na:
Predsednik Opštine, članovi Komisije, Direkcija za urbanizam, katastar i zaštitu životne sredine, Direkcija za ekonomiju, finansije i razvoj i Arhiva.

Predsedavajući Skupštine
Kemal Mersefi

Në mbështetje të neni 12 të Ligjit Nr. 051-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 18 të Ligjit Nr. 061-092 -Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 Qershor 2019, mori këtë:


VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE, PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË
PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR DHE
AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni i Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përberje prej 5 (Pesë) anëtarëve, si vijon:

1.1.	Vlora Dalloshi,	anëtare e KK nga PDK-së
1.2.	Shpend Krusha,	anëtar i KK, nga LVV.
1.3.	Zekeria Koxha,	anëtar nga ekzekutivi i komunës.
1.4.	Mentor Shehu,	anëtar nga ekzekutivi i komunës, dhe
1.5.	Milazim Salijaj,	anëtar nga shoqëria civile (gjeometër).
2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve nga pika 1 e këtij Vendimi.
3. Detyra dhe Përgjegjësia e Komisionit të ankesave është, pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë dhe shqyrtimi i tyre.
4. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesave të tyre.
5. Komisioni për ankesa në Komunë bënë shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave, brenda afatit ligjor mund të iniciojnë kontest administrative.
7. Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.
8. Për zbatimin e këtij vendim do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mersehi



01Nr. 104/02-23792/19
Kaçanik, 30.07.2019

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 031-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit 18 pika 3. e Ligjit Nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019), duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, 01Nr.104/02-23792/19, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur më datën 30 Korrik 2019, mori këtë :

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01Nr. 104/02-18863/19 TË DATËS 28.06.2019- PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE, PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-18863/19 i datës 28 Qershor 2019 — Për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet të paragrafi 1.4. e pikës 1 e Vendimit, ashtu që:
 - 2.1. Nga Komisioni me Kërkesën e tij, hiqet Mentor Shehu, anëtar i komisionit nga Ekzekutivi i Komunës.
 - 2.2. Në vend të anëtarit të hequr, caktohet për anëtar të komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, Edmond Mjaku.
3. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komisioni i Ankesave, Mentor Shehu, Edmond Mjaku, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.



Kryesuesi i Kuvendit
Këmal Merseli